

22 janar 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 31.01.2025, dhe Rregullores Disiplinore të FBK-së (RRD) të datës 30.08.2023, si dhe sipas Ankesës së z. Dren Pudarolli të datës 19.01.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), me datë 22.01.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e z. Dren Pudarolli e datës 19.01.2026;
- II. APROVOHET PJESËRISHT Ankesa e z. Dren Pudarolli e datës 19.01.2026 si pjesërisht e BAZUAR;
- III. NDRYSHOHET Pika II e Vendimit të datës 16.01.2026 të Komisionit Disiplinor, ashtu që bazuar në Nenin 53.1(a) dhe 54.1(b), z. Dren Pudarolli i shqiptohet masa disiplinore ndalesë loje apo kryerje të detyrës për tri (3) ndeshje në tri xhirot e rradhës nga data e këtij vendimi, duke përfshirë të gjitha kategoritë dhe të gjitha garat;
- IV. VËRTETOHET pjesa tjetër e Vendimit të datës 16.01.2026 të Komisionit Disiplinor;
- V. OBLIGOHET FBK që z. Dren Pudarolli t'ia kthejë taksën e paguar për parashtrimin e kësaj anekse.

A R S Y E T I M

Më datë 20.01.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), përmes postës elektronike, nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK, ka pranuar Ankesën e z. Dren Pudarolli të datës 19.01.2026 (tash e tutje "Ankesa"), të parashtruar përmes përfaqësuesit të tij z. Genc Vitaku, e cila ka të bëjë me Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 16.01.2026 (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me shqiptimin e masës disiplinore me ndalesë kryerje të detyrës për periudhë prej gjashtë (6) muaj.

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 21.01.2026, dhe ka shqyrtuar Ankesën e z. Dren Pudarolli, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga sekretaria.

Sipas kuptimit të KAA, z. Dren Pudarolli sfidon Vendimin e Komisionit Disiplinor ("KD") të identifikuar më sipër duke pretenduar ndër të tjera se KD ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe se KD ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe ka shqiptuar masë disiplinore joproporcionale. Rrjedhimisht, kërkon ndër të tjera nga KAA që të aprovojë ankesën, të anulojë Vendimin e KD, dhe të obligojë Komisionin e Nominimeve të FK-së që të kompensojë z. Dren Pudarolli me nominime shtesë për humbjet e pësuar nga Vendimi i sfiduar.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se z. Dren Pudarolli ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të Komisionit Disiplinor, dhe rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, bazën ligjore dhe nënligjore, dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, si dhe praktikën e rasteve të tjera se si kërkesat e ngjashme janë trajtuar nga organet e FBK, përkatësisht Komisionin Disiplinor, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

KAA potencon se dispozita përkatëse që trajton këtë rast është Neni 53.1(a) i RRD i cili thotë në pjesën relevante:

NENI 53 - SHKELJET

1. Shkelje veçanërisht në lidhje me delegatin apo gjyqtarin konsiderohen këto si në vijim:

- a) Delegati dhe gjyqtari të cilët me papërgjegjësi, pakujdesi, dhe angazhim të pamjaftueshëm e kryejnë detyrën.

* * *

Bazuar në Nenin e cituar më sipër, detyra e parë e KAA është që të vlerësojë nëse veprimet e z. Dren Pudarolli mund të cilësohen si "papërgjegjësi, pakujdesi, dhe angazhim të pamjaftueshëm" në kryerjen e detyrës. Duke analizuar faktet e rastit, KD ka vlerësuar dhe konstatuar se veprimi i z. Dren Pudarolli bie në kuadër të këtij përkufizimi të shkeljes.

KAA konstaton se KAA si shkallë e dytë, jep deferencë analizës së fakteve nga KD si shkallë e parë, dhe vetëm nëse ka prova se konstatimi i KD është i pasaktë mund të anulohet dhe/ose ndryshojë konstatimin e KD sa i përket vlerësimit të fakteve. Në këtë drejtim, KAA ka vlerësuar të gjitha provat e ofruara nga z. Dren Pudarolli si pjesë e ankesës, dhe vlerëson se nuk ka prova të pakontestueshme se KD ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike në rast. Rrjedhimisht, KAA vlerëson dhe konstaton se konstatimi i KD se veprimet z. Dren Pudarolli bien në kuadër të shkeljes sipas Nenit 53.1(a) duhet vërtetuar.

KAA njëheri konstaton se KD me të drejtë është bazuar në Nenin 53.1(a) si dispozitë e aplikueshme për të shqyrtuar çështjen e z. Dren Pudarolli. Prandaj, edhe pretendimi i z. Dren Pudarolli për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nuk qëndron dhe si të tillë, KAA e refuzon si të pabazuar.

Në anën tjetër, KAA ka vlerësuar edhe pretendimin e z. Dren Pudarolli, se masa disiplinore e shqiptuar është joproporcionale. Në këtë drejtim, KAA vën re Nenin 54 të RRD, e cila thotë:

NENI 54 – DËNIMET

1. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj individëve për shkeljet e përcaktuara në nenin 53 janë:

- a) Vërejtje;
- b) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për numër të caktuar të ndeshjeve nga një (1) deri në tri (3) ndeshje;
- c) Ndalesë loje apo kryerje të detyrës për periudhë të caktuar nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Në zbatim të kësaj dispozite, KAA ka parasysh pretendimet e z. Dren Pudarolli se ai nuk është recidivist, se ka rreth 20 vite përvojë si gjyqtar, se është ndër gjyqtarët më me përvojë në FBK dhe se gjatë tërë karrierës ka pasur sjellje sportive dhe profesionale. Për më tepër, KAA në veçanti ka parasysh edhe pretendimin e faktuar se nuk ka pasur ndonjë rast paraprak me sjellje të ngjashme, dhe se z. Dren Pudarolli ka merita, mirënjohje dhe çmime të ndryshme për kontributin e tij në basketboll. Për më tepër, ai është edhe anëtar i Bordit të Shoqatës së Gjyqtarëve të Basketbollit të Kosovës.

Në trajtim të kësaj pike, KAA gjithashtu vlerëson se KD me të drejtë të plotë ka theksuar pritjet se gjyqtarët kanë përgjegjësi të lartë për sjelljet e tyre gjatë ushtrimit të detyrës dhe se të njëjtit në asnjë rrethanë nuk guxojnë të bien pre e provokimeve nga publiku—pavarësisht natyrës apo seriozitetit të tyre. Andaj, duhet cekur se shkelja në fjalë nga z. Dren Pudarolli, në vlerësim të KAA, nuk mund të kalojë vetëm me vërejtje—sipas Nenit 54.1(a)—sepse përgjegjësia e gjyqtarëve për sjelljet e tyre gjatë ndeshjeve është tepër e lartë. Mirëpo, në zbatim të Nenit 25 të RRD ndaj rrethanave faktike të këtij rasti, KAA konsideron se masë më proporcionale që i përshtatet veprimit të z. Dren Pudarolli do ishte ajo nga Neni 54.1(b) sepse KAA ka drojën që aplikimi i masës nga Neni 54.1(c) për shkelje të parë nga z. Dren Pudarolli do tejkalonte standardet e proporcionalitetit. Prandaj, bazuar në këtë vlerësim, KAA ndryshon Pikën II të Vendimit të KD të datës 16.01.2026, me qëllim që masa e shqiptuar të jetë ajo nga Neni 54.1(b) si masë proporcionale ndaj shkeljes së bërë nga z. Dren Pudarolli.

Në fund, KAA gjithashtu vendosi të obligojë FBK-në që t’ia kthej z. Dren Pudarolli shumën/taksën e paguar në emër të pagesës për dorëzimin e ankesës. Bazuar në Nenin 7 të Rregullores për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit, dhe faktin se ankesa e gjyqtarit në fjalë është aprovuar pjesërisht dhe Vendimi i KD është ndryshuar, KAA urdhëroi që kjo taksë e paguar t’i kthehet z. Dren Pudarolli.

Prandaj, KAA, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 22 janar 2026



Vendimi i dërgohet:

- z. Dren Pudarolli, përmes përfaqësuesit Genc Vitaku
- Komisionit Disiplinor të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.